



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.296/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj -anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.296/2025 e datës 01.02.2025

II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 3,000.00 (tremijë) euro.

III. Detyrohet Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 01.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 31 janar 2025, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht kryetar i këtij subjekti politik si dhe Kryeministër i Republikës së Kosovës, ka publikuar një video në rrjetin social Facebook, me tekstin shoqërues si në vijim: *Dita e 20-të e fushatës, Prishtinë-Rahovec-Prishtinë. Të inspiruar nga tregimet e mbështetjes së nënave vetushqyese, në takime me qytetarë cep më cep Rahovecit. Kur jemi në atë anë të Kosovës, nuk mund të kalojmë pa u ndaluar në Krushë të Madhe. Prej aty, në dy tubime të njëpasnjëshme, një në Rahovec e një*

në Prishtinë", në të cilën video, në një sekuençë shihet z. Albin Kurti me në një takim me z. Husamedin Abazi - hoxhë - i punësuar në organizatë fetare. Për qëllime të argumentimit se personi që shihet në video është i punësuar në organizatë fetare, respektivisht i njëjti është Hoxhe, njoftojmë se z. Albin Kurti, këtë fakt e ka pohuar në një postim të publikuar në Facebook me datë 30 janar 2025, në të cilën ndër të tjerash ka shkruar "Gjatë vizitës në këtë fondacion, pata kënaqësinë të takoja edhe hoxhë Husamedin Bazi, me të cilin patëm diskutime të përzemërta. Ai gjithashtu më dhuroi kompletin e librave të Sami Frashëri të botuara nga Logos-A". PDK vlerëson se në veprimet e z. Albin Kurti janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar, të përcaktuar në nenin 5, par. 2, nënpar. 2.4 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024. Parashtruesi i ankesës në cilësinë e provës ka bashkangjitur, CD me përmbajtje të videoincizimit ku shihet z. Albin Kurti në takim me z. Husamedin Abazi Hoxhën të punësuarin në organizatë fetare <https://www.facebook.com/watch/?v=593223930300100&rdid=MDFrybR8QgBW53ZG>

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.02.2025, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), theksohet se ankesa është e pabazuar për arsye se takimi nuk ka ndodhur në kuadër të veprimtarisë fetare të Hoxhës Husamedin Abazi, përkundër se për hir të respektit Kryeministri Kurti i referohet me këtë titull/pozitë, gjithashtu takimi nuk ka ndodhur në ambientet e Bashkësisë Islame të 'Kosovës, ndonjë vend kulti fetar apo të ngajshme, mirëpo takimi ishte spontan dhe për qëllim ashtu siç shihet edhe në provën e bashkangjitur vizitë fondacionit i humanitar "Freskia". Më tutje në përgjigje në ankesë theksohet se Ligji sanksionon takimet me akterë fetarë në kuadër të fushatës zgjedhjeve, mirëpo jo çdo takim është në kuadër të fushatës, pasi që nga provat e bashkangjitura nuk vërehet asnjë mbishkrim mbi fushatën, madje kandidati z. Albin Kurti kishte pranuar edhe një dhuratë simbolike siç janë veprat e autorit Sami Frashëri dhe takimin me hoxhën nuk e ndërlihdh në asnjë moment me fushatën zgjedhore. Mos të harrojmë faktin se Kryeministri Kurti vazhdon të jetë Kryeministër aktual i vendit deri në momentin e konstituimit të legjislaturës së re, për çka takimet që kanë ndodhur jashtë fushatës nuk duhet të ndalën vctëm se ka filluar fushata, mirëpo të njëjtat nuk duhet të kenë ngjyrimë politike siç Ligji për Zgjedhjet dhe Rregullorja Zgjedhore i përcakton. Pra e thënë shkurt ky takim është nga Kryeministri me Fondacionin Humanitar "Freskia" dhe Hoxhën Husamedin Abazi e jo siç na u prezantua në ankesë si takim i kandidatit për deputetë z. Albin Kurti dhe hoxhës, ashtu siç ligji e sanksionon po që se ky takim do të kishte për qëllim fushatën zgjedhore, theksohet në përgjigje në ankesë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është bazuar

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i videos në rrjetin social facebook, nga kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht kryetar i këtij subjekti politik, është vërtetuar se ka bërë fushatë me përfaqësues fetar dhe organizatave bamirëse. Nga prova materiale e bashkangjitur ankesës, së Subjektit Politik PDK, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik, LVV, është shkelur Rregulla

Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që kandidati në fjalë, në fushatë zgjedhore ka përfshi të punësuarit në organizatë bamirëse – Fondacioni Freskia si dhe të punësuarin në këtë organizatë dhe përfaqësues fetar, për fushatë zgjedhore, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Gjithashtu Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e fotografisë në rrjetin social facebook nga kandidati i subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore është takuar me përfaqësues fetar dhe përfaqësues të organizatave bamirëse, e cila është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, dhe nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.296/2025 më datën 04.02.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform neni 118 par. 4 të LZP-së.